



Nr. 185/22.....

Data. 28.09.2022.....

Këshilli Mësimor Shkencor i FSI-së në përputhje me Statutin e Fakultetit dhe Rregulloren në fuqi për të ardhurat personale, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.9.2022 vendosi që të shpall:

KONKURS

për angazhim me honorar të personelit akademik në bazë të nevojave të Fakultetit për vitin akademik 2022/23

I. Kushtet e përgjithshme për angazhim:

- 1) Personeli akademik që aktualisht ka marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin e Studimeve Islame, nuk ka nevojë të konkurrojë për angazhim pasi që angazhimi i tyre do të bëhet në përputhje me kualifikimet dhe nevojën e Fakultetit në koordinim me dekanin.
- 2) Orët mbi normë nuk mund t'i jepen personelit akademik i cili e ka normën e plotë, përderisa nuk i plotësohet norma e plotë mësimdhënësve në marrëdhënie të rregullt pune nga lëmi i njëjtë.
- 3) Personeli i jashtëm akademik mund të angazhohet në FSI për një periudhë të caktuar kohore, me qëllim të realizimit të veprimtarisë arsimore, shkencore dhe hulumtuese, mbi bazën e një konkursi publik, për pagesë me honorar, si bashkëpunëtorë i jashtëm. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
- 4) FSI gjatë përzgjedhjes së stafit për angazhim në mësimdhënie (ligjërata) përparësi do tu jap kandidatëve të cilët kanë performancë të mirë.



II. Kohëzgjatja e kontratës për honorarë dhe kompensimi

- 1) Kandidatët të cilët do të përzgjedhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë.
- 2) Nënshkrimi i kontratave për angazhim me honorar do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve. Kontrata do të bëhet veç e veç për secilin semestër të vitit akademik 2022/23, varësisht nga nevoja e njësive akademike.
- 3) Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar i cili vërtetohet nga sekretari i Fakultetit.
- 4) Të gjitha kontratat e përkohshme të angazhimit me honorarë do të jenë të bazuara në dispozitat e Statutit në fuqi të FSI-së, dhe Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të FSI-së, dhe në bazë të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212 përkatësisht dispozitave të nenit 10, paragrafi 2, pika 2.2, nenit 11 dhe nenit 14 të këtij ligji.

III. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- 1) Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a) Kërkesën me biografi,
 - b) Certifikatën e lindjes,
 - c) Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar nga organi kompetent (kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë vendi duhet të sjellin vendimin për nostrifikim- barasvlerën e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë, doktoraturë),
 - d) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, në veçanti gjatë tri viteve të fundit, si dhe informatat e tjera specifike shtesë.
 - e) Dëshmitë për angazhimet paraprake në FSI, ose në ndonjë Institucion të akredituar të Arsimit të Lartë (IAL).
 - f) Dëshmia për njohjen e gjuhës arabe apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për konkurruesit.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet për angazhim do të njoftohen.



Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Fakultet dhe të skanuara në adresën elektronike **fakulteti.92@gmail.com**

Aplikacionet e arritura pas afatit, ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në adresën elektronike të FSI-së **<http://www.fsi-edu.net>**, respektivisht nga data 29.09.2022 deri më datën 06.10.2022. ora 14.00

Konkursi shpallet për 2 programet e akredituara, dhe atë si në vijim:

I. Programi “Teologji Islame” BA, për lëndët në vijim:

1. Kuran
2. Gjuhë arabe
3. Gjuhë shqipe
4. Stili i shkrimit akademik
5. Akaid
6. Gjuhë turke
7. Dave
8. Letërsi shqipe
9. E Drejta Civile
10. Ekonomi Islame
11. Sociologji
12. Pedagogji
13. Qytetërim Islam
14. Misticizmi
15. Gruaja dhe shoqëria
16. Objektivate e të Drejtës Islame
17. Bazat e Komunikimit

II. Programi “Teologji Islame” MA, për lëndët në vijim:

1. Koncepti i perceptimit të muslimanëve ndaj feve të tjera
2. Historia dhe bashkëkohorja e Islamit në Evropë
3. Studime të Kuranit në Evropë
4. Zhvillimi i shkencave të hadithit ne Evrope
5. Metodologjia e hulumtimit
6. Zhvillimi i kulturës islame në Ballkan
7. Sfidat evropiane te ligjit Islam
8. Arti Islam
9. Dialogu ndërfaqet në kontekstin e Kosovës dhe Evropës Juglindore

DEKANI

Prof. assist. dr. Islam Hsani

